



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Thirrje për Shprehje Interesi

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), në kuadër të Komunës së Prishtinës, që synon ngritjen e shërbimeve të transportit publik, me fokus të veçantë në shërbimet e transportit me autobus urban, fton operatorët ekonomikë privatë që ofrojnë transport publik, në kuadër të vullnetit tyre, që të shprehin interesin e tyre për të operuar një (1) nga Linjat e transportit (apo Grupin e linjave), me tarifë kompensimi të paracaktuar, që do të paguhet nga Komuna, € për km, me kusht që të përmbushen kriteret e mëposhtme:

Një listë e përkohshme e Linjave (apo Grupit të linjave) dhe km vjetore përkatëse, është bashkangjitur në Shtojcën 1. Duke vënë në dukje se përmbajtja e secilës Linjë (apo Grup të linjave) mund të jetë subjekt i ndryshimit para dhe pas nënshkrimit të Kontratës së Shërbimit Publik.

Kjo Thirrje për Shprehje të Interesit mbështetet në klauzolat e marrëveshjes për mbështetjen e projektit me nr: 4159 të datës 19/12/2022 ndërmjet Komunës së Prishtinës, N.P.K. "Trafiku Urban SH.A. dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për ofrimin e flotës së re të autobusëve, gjithashtu kjo 'Shprehje e Interesit' bazohet në Rregulloren për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës me numër 01. nr.110-41910, datë 29.03.2013, si dhe Rregulloren për caktimin e linjave dhe linjës së transportit të rregullt urban të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Prishtinës, miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës në vitin 2006. Gjithashtu, kjo nismë është pjesë e riorganizimit dhe përmirësimit të transportit publik që bazohet në Planin e miratuar për Lëvizshmërinë e Qëndrueshme Urbane, ku përmes këtij plani zbatohet dhe "Përmirësimi, Rregullimi i transportit publik dhe Monitorimi i ofrimit të Shërbimeve të transportit të udhëtarëve me autobus" është e paraparë.

Operatorët ekonomikë të interesuar duhet të ofrojnë informacion që demonstroi disponueshmërinë e flotës së autobusëve dhe personelit për të operuar itinerarin dhe të planifikuar dhe frekuencën përkatëse (prezentuar në Shtojcën 1), dhe përvojën përkatëse në ofrimin e shërbimeve të transportit publik.

Kërkesat e flotës së autobusëve

Në përputhje me planin e përmirësimit të shërbimeve, pritshmëritë nga Komuna e Prishtinës janë që **flota aktuale/ekzistuese e autobusëve mund të përdoret për**

periudhën deri në 12 muaj pas nënshkrimit të kontratës, ndërsa flota e re apo e përmirësuar dhe funksionimi i autobusëve do të bëhen të detyrueshme pas kësaj periudhe.

Është e rëndësishme të theksohet se Operatorët Ekonomikë të Interesuar që shprehin interesin e tyre nuk janë në asnjë mënyrë të detyruar të lidhin marrëveshjen e kontratës dhe në mënyrë të ngjashme, kjo 'shprehje interesi' në asnjë mënyrë nuk u garanton palëve të interesuara një 'Kontratë'. Detajet përfundimtare mbi rimbursimin (për km), opsionet e përmirësimit të flotës dhe planet e përgjithshme të përmirësimit të shërbimit do të diskutohen dhe bien dakord nga të dyja palët, përpara nënshkrimit të kontratës.

Së fundi, operatorët ekonomikë të interesuar duhet të 'shprehin interesin e tyre' duke paraqitur dokumentet dhe dëshmitë e mëposhtme si më poshtë:

1. Të japë deklaratë, letër/konfirmim me shkrim për plotësimin e të gjitha kriterëve dhe kërkesave të kërkuara;
2. Të sigurojë leje/licence/ certifikatë e automjetit për transport publik të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit aktiv afarist për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve në Komunën e Prishtinës, ose të sigurojë dëshmi për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve në linjën ku aplikoni për dhjetë vitet e fundit ose dëshmi zyrtare të itinerarit dhe rendit të udhëtimit për linjat përkatëse. Pasqyrat financiare nga Zyra e Administratës Tatimore për tetë vitet e fundit;
3. Të jetë biznes i regjistruar në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK). Ju lutemi paraqisni dëshmi: Certifikata e regjistrimit (kopje e noterizuar)
4. Vërtetimin nga Zyra e Administratës Tatimore që vërteton se operatori ekonomik nuk ka borxhe ndaj Administratës Tatimore.
5. Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime ose nuk ka ndonjë ndalesë ligjor. Ju lutemi paraqisni prova origjinale.
6. Të ketë selinë në territorin e Kryeqytetit të Prishtinës. E dëshmuar me Certifikatë Regjistrimi nga ARBK.
7. Të jepni një listë të autobusëve me targa të vlefshme për Linjën (apo Grupin e linjave) që po aplikoni (kopje e noterizuar e dokumentit të regjistrimit të flotës) dhe listën e personelit dhe lejet e drejtimit të tyre (kur është e aplikueshme). Një OE nuk mund të aplikojë në më shumë se një (1) Linjë (apo Grup të linjave) me të njëjtën flotë autobusësh.
8. Secili operator duhet të aplikojë në linjën e tyre ekzistuese, në të cilën janë pajisur me licence ose leje nga DSHPMSH.

Të gjithë operatorët ekonomikë inkurajohen të komunikojnë dhe bashkëpunojnë ne mes veti dhe të tregojnë vullnet bashkëpunimi në mes veti për ngritje dhe zbatim të standardeve të shërbimit në transport publik, dhe në veçanti të konsiderojnë bashkëpunimin për porosi të përbashkëta të autobusëve të rinj dhe mirëmbajtje, me qëllim që të pranohet oferta më e mirë.

Operatorët ekonomikë që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura do të kontaktohen për të diskutuar mbi 'Kushtet e Plota të Angazhimit' ë dhe në rast të përmbushjes me sukses të kriterëve, Operatorëve Ekonomikë do t'u ofrohet një kontratë (dhe

lejet/licencat e mëvonshme) për ushtrimin e aktivitetit të biznesit për ofrimin e transportit të udhëtarëve në Komunën e Prishtinës, linja urbane, në kohëzgjatje prej tetë (8) vitesh dhe do të fitojë të drejtën e nënshkrimit të kontratës për ofrimin e shërbimit të autobusëve.

Letra motivuese e titulluar 'Shprehje e Interesit' e nënshkruar dhe e vulosur, e cila përmban deklaratën - letër/konfirmim me shkrim mbi përmbushjen e të gjitha kriterëve dhe kërkesave të kërkuara, së bashku me dokumentet/dëshmitë e lartpërmendura duhet të dorëzohen në Komunën e Prishtinës, kati përdhes, Qendra e Shërbimit të Qytetarëve, në afat prej 04.07.2024 deri në 24.07.2024, ora 16:00.

Vërejtje: Kërkesat me dokumente të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

ANEKS 1

Lot	Linja	Kilometrat e Planifikuara					Gjatësia e autobusit ***
		Plani ditor i linjave			Mujore**	Vjetore**	
		Gjatësia KM *	Totali i udhëtimeve vajtje-ardhje *	Total KM			
1	Line Nr.3A	9.5	97	1,844	55,305	663,660	Mesëm <11m
2	Linja Nr.5	7	22	728	21,840	262,080	Vogël
3	Linja Nr.6	7.3	45	657	19,710	236,520	Vogël
4	Linja Nr.6a	10	44	880	26,400	316,800	Vogël
5	Linja Nr.7	8.3	65	1,071	32,121	385,452	Mesëm
6	Linja Nr.7a	6.3	44	554	16,632	199,584	Mesëm
7	Linja Nr.7b	14.8	9089	1,332	39,960	479,520	Mesëm
8	Linja Nr.8	18	10	360	10,800	129,600	Mesëm
9	Linja Nr.10 + 10a+ 10b+ 10c + 20	11.48	109	2,332	69,948	839,376	Mesëm /E madhe
10	Linja Nr.11	15	15	450	13,500	162,000	Mesëm
11	Linja Nr.13	31.5	6	378	11,340	136,080	Mesëm
12	Linja Nr.17	28	7	392	11,760	141,120	Mesëm
13	Linja Nr.25	17.8	10	356	10,680	128,160	Mesëm

SHËNIME:

* Gjatësia dhe frekuenca për çdo Linjë (apo Grup të linjave) bazohet në të dhënat e marra nga komuna e Prishtinës të cilat do të vërtetohen edhe në teren si dhe rast se ndonjë operator është duke operuar dhe nuk i përfshira në tabelën e mësipërme ka të drejt të aplikimit;

** Vlerësimet mujore të km llogariten në cikle 30 ditore/në muaj (pa dallim në ditët e javës kundrejt fundjavave: siç janë marrë nga komuna e Prishtinës) ndërsa vjetore bazohen në 12 muaj/vit

*** Gjatësia e autobusit: E vogël: <10 m; Mesatare: 10,0-13,5m; E madhe: >13,5 m